

VENDIM
Nr.362, datë 6.5.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.268, DATË 6.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”, bashkëlidhur vendimit nr.268, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtjen e rregullores, emërtimet:
 - a) “Sekretariati Teknik” dhe “Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit” zëvendësohen me “AMBU”;
 - b) “Sekretari Kombëtar i Ujit” zëvendësohet me “Drejtori i Përgjithshëm i AMBU-së”;
 - c) “ministri propozues” zëvendësohet me “propozuesi”.
2. Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
“1/1. “AMBU”, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.”;
 - b) Pikat 9 dhe 11 shfuqizohen.
3. Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në pikën 1, pas fjalës “... ministrisë ...” shtohen fjalët “.. dhe AMBU-së ...”.
 - b) Në pikën 2, përpara fjalëve “Ministri përgjegjës ...” shtohen fjalët “Kur projektakti është hartuar nga ministritë ...”.
 - c) Në pikën 3, pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:
“Nëse, pas mbarimit të afatit të sipërpërmendur, mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin.”.
4. Në pikën 1, të nenit 9, pas fjalëve “... ndërmjet ministrive ...” shtohen fjalët “... ose me AMBU-në ...”.
5. Në pikën 1, të nenit 10, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve “... ministri përgjegjës për fushën e veprimtarisë shtetërore ...” shtohen fjalët “... ose nga AMBU-ja ...”.
 - b) Fjalia e dytë shfuqizohet.
6. Pika 1, e nenit 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Subjekti i interesuar paraqet kërkesën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve e autorizimeve për përdorim burimi ujor, për marrjen e lejes ose të autorizimit, në rastet kur miratimi i tyre është kompetencë e Këshillit Kombëtar të Ujit.”.
7. Pas pikës 1, të nenit 14, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:
“1/1. AMBU-ja u dërgon për mendim, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve e autorizimeve për përdorim burimi ujor, kërkesat për leje dhe autorizim institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KKU dhe institucioneve të tjera, që janë pjesë e bashkërendimit institucional në këtë proces.”.
8. Shkronjat “c” dhe “ç”, të nenit 26, ndryshohen, si më poshtë vijon:
 - “c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;
 - ç) mosmiratimin.”.
9. Pika 4, e nenit 27, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“4. Procesverbali nënshkruhet nga stenografi dhe drejtori i Përgjithshëm i AMBU-së.”.

10. Në nenin 32, pas fjalëve “... ministri përgjegjës.” shtohen fjalët “... ose Kryeministri.”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama